



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 36 Prot

Tiranë, më 12.06 2009

VENDIM Nr. 6 dt. 04.06.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 04.06.2009,

VENDOSI:

Të miratojë kërkesat për licensë:

1. Ajet Nallbani. Kërkesë për pajisje me licensë të kat A.
2. Kërkesë e arkitektes Lida Miraj, për pajisjen me licensë profesionale personale për kategorinë A, "Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës".
3. Kërkesë e shoqërisë "AD-STAR", për rifreskim licensë të kategorisë C, "Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi", me drejtues teknik Pirro Thomo.
4. Kërkesë për rinovim licensë ark. Rest. Agron Doraci, Drejtues teknik i shoqërisë së ndërtimit "PROINVEST". Jepet licensa për kategoritë A/2, A/3, A/4.
5. Kërkesë për rinovim licensë shoqëria e ndërtimit "PROINVEST" me Drejtues Teknik Ark. Rest. Agron Doraci.
6. Kërkesë e shoqërisë së ndërtimit "ELKRI" sh.p.k, për pajisjen me licensë të Kategorisë C, "Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi", me drejtues teknik Jorgo Xuhano,
7. Kërkesë e arkitektit Aleko Papakozma, për pajisjen me licensë profesionale personale për kategorinë A/2,A/3,A/4 "Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës".
8. Kërkesë e shoqërisë së ndërtimit "JOGI CO" sh.p.k, për pajisjen me licensë të Kategorisë C, "Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi", me drejtues teknik Gentian Stratobërdha.
9. Kërkesë e Z. Gazmend Muka, për pajisjen me licensë profesionale personale për

- ... kategoritë B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskëve.
... B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e vepra të arti në dru.
10. Miratohet me shumicë votash, kërkesa për liçensë e Z. Veli Shehu, për pajisje me liçensë të kategorisë A/2, A/3, A/4. "Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës".

Nuk u miratuan dhe do të verifikohet dokumentacioni për:

1. Kërkesë e inxhinierit Nasho Xheka, për pajisje me liçensë personale profesionale të kategorisë A, "Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës".
2. Kërkesë e arkitektit Genci Bregu, për pajisjen me liçensë profesionale personale për kategorinë A, "Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës".

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R
ARDJAN TURKU**



**SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

